

RELACION

Projektligji " Për financimin e partive politike" përbën një rregullim ligjor të plotë dhe të unifikuar të financimit të partive politike, gjatë vitit kalendarik, si dhe të subjekteve zgjedhore gjatë fushatave zgjedhore. Ky projektligj synon të rregullojë, në një ligj të vetëm mënyrën dhe kushtet e financimit, administrimin, verifikimin, mbikëqyrjen, transparencën dhe raportimin për financimin e subjekteve zgjedhore për fushatën zgjedhore dhe partive politike për vitin kalendarik në Republikën e Shqipërisë, kuadër ligjor i cili aktualisht është i fragmentuar dhe i paplotë.

Rregullimi i financimit të partive politike dhe subjekteve zgjedhore në një ligj të vetëm, jo vetëm ndihmon dhe lehtëson partitë politike në zbatimin e tij por njëkohësisht ndihmon dhe institucionin i cili do të jetë i ngarkuar për monitorimin dhe mbikëqyrjen financiare të fushatave zgjedhore dhe aktivitetit normal financiar të partive politike.

Gjithashtu projektligji synon plotësimin dhe zbatimin e rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore, një transparencë më të madhe financiare gjatë fushatës zgjedhore, si dhe dhe forcim të rolit mbikëqyrës të institucionit shtetëror monitorues.

Hartimi i dispozitave të projektligjit " Për financimin e partive politike" është mbështetur në:

- a) Rekomandimet e dhëna për zgjedhjet e përgjithshme dhe ato vendore në Shqipëri nga OSBE/ODIHR për vitet 2013, 2015, 2017 dhe 2019.
- b) Legjislacionin në fuqi që rregullon financimin e subjekteve zgjedhore dhe partive politike si Kodi Zgjedhor dhe Ligji "Për partitë politike"
- c) Raportin e projektit të Këshillit të Europës nëpërmjet *Horizontal Facility Program*.
- d) Praktikën me të mira të arritura deri tani, kryesisht me ndryshimet e ligjit nr.8580 datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike", ndryshuar me ligjin nr. 90/2017, datë 22.05.2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8580 "Për Partitë Politike"

FINANCIMI I FUSHATËS

ODIHR 2019 - Financimi i Fushatës

14. Duhet të shihet mundësia e rishikimit të ligjit për të garantuar që KQZ-ja i ka kompetencat dhe procedurat e duhura për të mbikëqyrur dhe për të siguruar zbatimin në mënyrë efektive të rregullave të financimit të partive dhe fushatave.

ODIHR 2017 - Financimi i Fushatës

16. Duhet të harmonizohen rregullat për financimin e fushatës dhe duhet të hartohen akte nënligjore me qëllim që të sigurohet një metodologji solide dhe qasje në informacionin e plotë mbi financimin e fushatës për ekspertët financiarë dhe zgjedhësit para dhe pas ditës së zgjedhjeve. Mund t'i kushtohet vëmendje përcaktimit të afateve për përfundimin e auditimeve paszgjedhore.

PËRDORIMI I BURIMEVE ADMINISTRATIVE

ODIHR 2019 - Rekomandimi kryesor nr. 2

2. Autoritetet dhe partitë politike duhet të ndërmarrin masa maksimale për eliminimin e problemit të hershëm të shpërdorimit të burimeve administrative në zgjedhje dhe në periudhat midis zgjedhjeve. Autoritetet duhet të nxjerrin rregulla të sakta që përcaktojnë se si mund dhe nuk mund të përdoren burimet publike për qëllime zgjedhore. Hapa të mëtejshëm duhet të merren për arritjen e depolitizimit të shërbimit civil dhe për të garantuar mosushtimin e presionit ndaj zgjedhësve me qëllim pjesëmarrjen e tyre në aktivitete të fushatave zgjedhore apo votimin në një mënyrë të caktuar.

ODIHR 2013 - Fushata Zgjedhore

18. Abuzimi me burimet shtetërore, përfshirë burimet njerëzore, për qëllime të fushatës zgjedhore mund të ndalohe në mënyrë më të efektshme nëpërmjet zbatimit më të mirë të ligjit dhe vënies përpara përgjegjësisë të personave që e shkelin atë.

ODIHR 2015

13. Autoritetet dhe partitë politike duhet të sigurohen që të mos ushtrohet presion ndaj punonjësve të sektorit publik, mbështetësve politikë apo personave të tjerë për të marrë pjesë në aktivitetet e fushatës apo për të votuar në një mënyrë të caktuar. Organet e zbatimit të ligjit duhet të marrin hapa më të vendosura për të parandaluar, identifikuar, hetuar dhe ndjekur penalisht rastet e provuara të presionit dhe frikësimit të zgjedhësve, si edhe të keqpërdorimit të burimeve shtetërore për qëllime të fushatës.

Projektligji i propozuar përputhet, por njëkohësisht sjell ndryshime në disa aspekte thelbësore të mënyrës dhe kushteve të financimit, në krahasim me projektet e paraqitura deri tani.

Risia më e madhe e projektligjit konsiston në reduktimin drastik të masës së financimit privat të subjekteve zgjedhore, gjatë fushatave zgjedhore, i cili **nuk duhet të jetë më i madh se 50 % i masës së financimit të cilin subjektet e kanë përfituar nga buxheti i shtetit.**

Disa risi të tjera të projektligjit i rendisim më poshtë:

- Ulje e kostos së fushatave zgjedhore, kryesisht nëpërmjet minimizimit të fondeve jo publike (dhurimet) të lejuara duke bazuar shpenzimet e fushatës kryesisht në fondet publike. Ulja e kostos së zgjedhjeve sigurohet gjithashtu edhe nëpërmjet parashikimeve ligjore të qarta mbi fondet e lejuara, kufijve dhe kufizimeve më të efektshme mbi aktivitete të caktuara të fushatës dhe masave për të rregulluar dhe për të bërë më transparente vendosjen e çmimeve të shërbimeve të lidhura me zgjedhjet;
- Kufizime më të forta mbi donacionet që vijnë nga përfituesit faktikë/të mundshëm të kontratave shtetërore) dhe shpërdorimit të burimeve shtetërore;
- Forcimin e monitorimit dhe verifikimit financiar nëpërmjet verifikimit të dyfishtë jo vetëm nga monitoruesit dhe audituesit ligjor por dhe nga ekspertet financiarë të partive politike; Është konsideruar e domosdoshme ruajtja e të dy mekanizmave të verifikimi, si monitoruesit ashtu dhe audituesit, për shkak të rezultateve që duket sikur po sjell në praktikë përplasja e gjetjeve të monitoruesve gjatë periudhës së fushatës me raportet e audituesve financiarë.
- Futja e mekanizmit të ekspertëve financiarë të subjekteve politike të cilët do të verifikojnë drejtpërdrejt pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave transaksione relevante financiare pranë bankave të nivelit të dytë.
- Sigurimin që sanksionet për shkeljet të jenë jo vetëm frenuese dhe parandaluese nëpërmjet sanksionit financiar por të garantohet edhe përshkallëzimi i sanksionit në varësi të shkeljes.

Prezantimi si risi i nocionit të shpalljes së **pavlefshmërisë së mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit nga KQZ-ja, për të zgjedhurin ose subjektin zgjedhor**, kur shkelja e dispozitave për financimin e partive politike përbën vepër penale.

Një risi tjetër përbën parashikimi i kontrollit të ndërsjelltë të shpenzimeve financiare të subjekteve zgjedhore, nëpërmjet ekspertëve kontabël të propozuar nga subjektet të cilët auditojnë subjektet rivale (*peer review*).

Gjithashtu dispozitat tranzitore parashikojnë rritjen e masës së financimit shtetëror, për partitë politike, në zgjedhjet e ardhshme bazuar mbi një vlerësim që duhet t'u bëhet nevojave të subjekteve për të bërë një fushatë zgjedhore dinjitoze në kushtet kur masa e financimit privat reduktohet ndjeshëm. Vlerësimi i nevojave duhet të bëhet nga KQZ dhe nga një institucion tjetër/ partner ndërkombëtar i paanshëm dhe i besueshëm. Gjithsesi, zgjidhja e propozuar nga ana jonë është që financimi publik në zgjedhjet e ardhshme të jetë sa trefishi i shumës së akorduar nga buxheti i shtetit në zgjedhjet pararendëse.

Për shkak se NDI dhe CoE, vitet e fundit kanë asistuar KQZ dhe partitë politike në çështjet e financimit të politikës, në kuadër të një projekti afatgjatë, si dhe për shkak të nivelit të ekspertizës së pavarur ndërkombëtare të kontraktuar nga ato, sugjerohet që projektligji i propozuar, përpara miratimit t'i përcillet për mendime dhe sugjerime zyrës së NDI dhe CoE në Tiranë.

[Shqiptaria.com]